



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1447 Prot.

Tiranë, më 16.07 2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 55 dt. 16.07 2026

**PËR**  
**NJË NDRYSHIM NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË**  
**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, pika 1, gërma (ç), në Statutin e UST-së neni 43, gërma r), në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", në Vendimin e Senatit nr.13, datë 30.01.2026 "Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 11, datë 02.02.2026 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026, në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 1198/1 prot., datë 13.07.2026 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor i Asociuar", në Vendimin e Senatit Akademik nr. 110 datë 16.07.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 16.07.2026,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe përcaktimit të nivelit të pagës si më poshtë vijon:

**Znj. Blerina Behar Aliaj**, me gradë shkencore "Doktor", kategoria "Lektor" pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, kalon me titullin akademik "Profesor i Asociuar", kategoria "Profesor i Asociuar" nga data 11.06.2026 e në vazhdim.

2. Niveli i pagës do të jetë sipas Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 50, datë. 31.10 2022 "Miratimin e nivelit të pagave sipas VKM në nivel maksimal të personelit akademik të UST".

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore, Administratori, Drejtoria e Burimeve Njerëzore Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur ÇOBANI**

